



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE  
VLORE

Nr. 2120Akti  
Dt.Regj. 17.12.2015

Nr . 193. Vendimi  
Date 19.02.2016

VENDIM

**“NË EMËR TË REPUBLIKËS”**

Sot me date 19.02.2016, Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Vlore e përbëre nga gjyqtari KEN DHIMA, asistuar nga sekretaria gjyqësore Kamila Petriti, shqyrtoi ne seance gjyqësore me dyer te hapura çështjen civile me Nr. 2120 akti date 17.12.2015 qe i përket:

**PADITES:** Shoqëria "MARTINI" SH.P.K., me seli ne Rruga . "Gjergj Araniti",Lagja. "Pavarësia", Tek Hotel Martini. Vlore. Përfaqësuar nga Av. Bledar Zani.

**TE PADITUR:** Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlore,ne mungese.

Drejtoria e Apelimit Tatimor, pranë Drejtorisë se Përgjithshme te Tatimeve, Rr. "Gjin Bue Shpata", pranë Stadiumit "S. Stermasi", Tirane, ne mungese.

**PERSONI I TRETE** : Zyra Vendore e Avokatit te Shtetit Vlore, ne mungese.

**OBJEKTI:** Shfuqizimin e aktit administrativ "Njoftim vlerësimi për detyrimet" nr. 10309 Prot, dt. 02.09.2015, te D. R. Tatimeve Vlore. 2. Shfuqizimin e Vendimit nr. 28783/1 Prot., dt. 24.11.2015 te Drejtorisë se Apelimit Tatimor Tirane.

BAZA LIGJORE: Neni 15 dhe 17"b" dhe "9" te Ligjit nr. 49/2012 "Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrveshjeve administrative " te ndryshuar. Neni 109/2 i Ligjit nr. 9920 dt. 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne Republikën e Shqipërisë " te ndryshuar.

Ne përfundim te shqyrtimit gjyqësor te zhvilluar me dyer te hapura gjykata pasi dëgjoi paditësin i cili kërkoi pranimin e padisë sipas objektit , i padituri rrezimin e kerkesepadise si e pa bazuar ne prova dhe ne ligj , dhe pasi shqyrtoi provat e administruara ne dosje dhe bisedoi ceshtjen ne tërësi, si përfundim,

### V E R E N

Se para Gjykatës Administrative te Shkalles se Pare Vlore pala paditëse Jurgen Frakulla ka paraqitur një padi me objekt si me sipër.

Gjykata çmon se kjo padi është ne kompetencën funksionale te kësaj gjykate konform Ligjit Nr.49/2012 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative" Neni 10 ne baze te te cilit rezulton se: "Gjykata administrative e shkallës së parë shqyrton mosmarrëveshjet administrative të parashikuara në nenin 7 të këtij ligji, me përjashtim të atyre që lidhen me aktin nënligjor normativ".

Gjykata çmon se është ne kompetencën lëndore te kësaj gjykate shqyrtimi i kësaj çështjeje pasi padia është një prej atyre te parashikuara ne nenin 7 i Ligjit Nr.49/2012 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative", ne baze te te cilit rezulton se: "Kompetenca lëndore Gjykatat administrative janë kompetente për: a) mosmarrëveshjet që lindin nga aktet administrative individuale, aktet nënligjore normative dhe kontratat administrative publike, të nxjerra gjatë ushtrimit të veprimitarisë administrative nga organi publik."

Gjithashtu gjykata çmon se është ne kompetencën tokësore te kësaj gjykate shqyrtimi i kësaj çështjeje pasi sipas nenit 11 te Ligjit Nr.49/2012 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative", rezulton se : "Paditë kundër veprimit administrativ shqyrtohen në gjykatën administrative të shkallës së parë, që përfshin territorin, në të cilin organi publik ka kryer veprimin administrativ që kundërshtohet". Pale e paditur ne rastin konkret eshte Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlore.

Gjate shqyrtimit gjyqësor u provua se Shoqeria "MARTINI" SH.PK. ushtron

Gjate shqyrtimit gjyqesor u provua se Shoqeria "MARTINI" SH.PK. ushtron aktivitetin ne fushën e hotelerise, bar e restorant, qysh prej vitit 2003.

Ne datën 05.09.2015 Shoqërisë i komunikohet Njoftim Vlerësimi Për Detyrimet nr. 10309 nga ana e pales se paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Vlore. Nepermjet ketij akti, pala paditese eshte njoftuar nga pala e paditur se nga ana e ketij te fundit eshte vendosur masa e gjobes ne shumen 50.000 leke, per shkak se: "*Ne momentin e kontrollit ne pune, u gjet z. Azem KASEMI i cili eshte i pasiguruar*".

Sic rezulton edhe nga ekstrakti historik leshur nga Q.K.R., z, Azem KASEMI eshte ortaku i vetem i Shoqerise, nderkohe qe ai nuk ka funksione drejtuese. Bazuar ne VKM nr. 77 dt. 28.01.2015 "Per kontributin e detyrueshem dhe perfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqerore dhe sigurimin shendetesor", paragrafi I, pika 1/c, ky subjekt nuk ka funksione drejtuese ne Shoqeri, me qellim qe te sigurohet ne menyre te detyrueshme.

Gjate shqyrtimit gjyqesor nga provat shkresore te paraqitura nga vete pala paditese rezultoi e provuar se z. Azem KASEMI se nuk ushtron me asnje lloj aktivitet prane Shoqerise "Martini" shpk . Ai eshte gjendur aty rastesisht dhe nuk ka qene duke punuar.

Pala paditëse ka ushtruar te drejten e apelit administrative drejtuar Drejtorisë se Apelit Tatimor me ane te se ciles iu kërkua te shfuqizonte aktin administrativ te Drejtorisë Rajonale te Tatimeve Vlore, nëpërmjet te cilit paditësi është dënuar me gjobe.

Me Vendimit nr. 28783/1 Prot, dt. 24.11.2015, prej Drejtorise percaktuar ne aktin administrativ Njoftim Vlerësimi Për Detyrimet nr. 10309, dt. 02.09.2015 te Drejtorise Rajonale te Tatimeve Vlore, për mosdeklarim te një punonjësi ne organin tatimor .

Z. Azem KASEMI, ne baze te ligjit nuk ka qene i detyruar te sigurohej, pasi ai ka ~~gezuar vetem cilesine e ortakut te vetem dhe jo te nje te punesuar prane ketij~~ subjekti.

Gjykata cmon se akti adinistrativ " Njoftim Vleresimi" eshte nxjerre pa u respektura procedura , pasi nuk I eshte dhene e drejta subjekti as te njihet me aktet dhe as te shprehe qendrimin e tij ne lidhje me kete akt.

Ne keto kushte, gjykata vlereson se mosrespektimi i procedures per nxjerrjen e nje akti administrativ sjelle si pasoje pavlefshmerine e vete aktit.

Shkelja ne menyre flagrante te formes dhe procedures per nxjerrjen e aktit administrative, con domosdoshmerisht ne pavlefshmeri absolute. Respektimi i formes dhe i procedures per nxjerrjen e aktit administrativ perben nje tjetër element te rendesishem qe percakton vlefshmerine e tij. Shkelja e formes dhe e procedures mund te paraqitet ne menyra te ndryshme, por jo te gjitha shkeljet qe lidhen me formen dhe proceduren mund te shpien detyrimisht ne pavlefshmerine e aktit. Mosrespektimi i ketyre elementeve duhet te jete i atij karakteri dhe asaj

shkelje e parandalueshme e procedurës apo formes së aktit nuk mund të shkaktojë pavlefshmësi absolute të aktit. Natyra e shkeljes vlerësohet nga vete organi që shqyrton pavlefshmërinë e aktit.

Prej gjykatës vlerësohet se mosrespektimi i procedurës në këtë rast është i një karakteri që ka ndikuar në vete nxjerrjen e aktit.

Gjykata vlerëson se pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Vlore, i cili është dhe organi që ka nxjerre "Njoftim Vlerësimi për Detyrimet" me Nr.10309, dt.02.09.2015, e ka nxjerre këtë akt në kundërshtim të plotë me procedurën e parashikuar nga Ligji Nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" dhe Udhezimin e Ministrit të Financave ku në nenin 37 të tij përcaktohet qartë se: *"Perpara marrjes së një vendimi ekzekutiv nga ana e administratës tatimore, tatimpaguesi ka të drejtë të presë nga kjo e fundit që të degjohet me vëmendje për të dhënë sqarimet e nevojshme, për të parashtruar pretendimet që ka, për të shpjeguar rrethanat konkrete të tjera. Ai ka të drejtë gjithashtu të sigurohet se shpjegimet dhe pretendimet e tij do të shqyrtohen me vëmendje e ndershmëri nga administratat tatimore në funksion të marrjes së vendimeve të drejta dhe në konformitet me ligjet tatimore"*.

Akti Administrativ "Njoftim Vlerësimi për Detyrimet" është marrë pa u thirrur subjekti pa u dëgjuar ai për shkaqet e shkeljes dhe argumentet e pretendimit të tij. Duke mos u thirrur atij i mohohet e drejta ballafaqimit, argumentit dhe paraqitjes së provave shkresore që disponon.

Për arsyet e mësipërme edhe akti tjetër administrativ Vendimi nr.10309, dt.02.09.2015 i Drejtorisë së Apelitit Tatimor i cili është mbështetur mbi aktin administrativ të nxjerre nga Drejtoria Rajonale Tatimore Vlore "Njoftim Vlerësimi për Detyrimet", është nxjerre pa marrë parasysh asnjë nga pretendimet e argumentat e bazuara mbi prova të pales ankimese.

Për sa me sipër gjykata vlerëson se kërkesepadia është e bazuar në prova dhe në ligj dhe si e tillë duhet të pranohet.

### **Për këto arsye**

Gjykata bazuar në Ligjin Nr 49/2012 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", nenet 115, 116, e vijues të Kodit të Procedurës Administrative, Ligji nr. 10279, të

nenet 115, 116, e vijues te Kodit te Procedures Administrative, Ligji nr. 10279, te dates 20.05.2010 “Per Kundravajtjet Administrative” , Ligji Nr. 9920, te dates 19.05.2008 “Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise” , Udhezimit i Ministrin te Financave Nr. 24, te dates 02.09.2008 “ Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise”.

**VENDOSI:**

1. Pranimin e kerkesepadise si te bazuar ne prova dhe ne ligj.
2. Deklarimin e pavlefshmërise se aktit administrativ “ Njoftim Vleresimi per detyrimet me Nr. 10309 Prot, date 02.09.2015 “ te nxjerre nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlore si akt administrativ i nxjerre ne kundershtim me ligjin dhe shfuqizimin e tij.
3. Deklarimin e pavlefshmërise se aktit administrativ Vendim me Nr.28783/1 Prot, date 24.11.2015 te Drejtorise se Apelimit Tatimor si akt administrativ i nxjerre ne kundershtim me ligjin si dhe shfuqizimin e tij.
4. Shpenzimet gjyqësore ne ngarkim te paleve te paditura solidarisht.
5. Ndaj ketij vendimi nuk leshohet urdher ekzekutimi.
6. Urdherohet Zyra e permbarimit me ekzekutimin e ketij vendimi menjehere.
7. Ky vendim është i formës se prere dhe ndaj tij nuk lejohet ankim .

U shpall në Vlore, sot me dt. 19.02.2016.

**SEKRETARE**  
**KAMILA PETRITI**



**GJYQËTAR**  
**KENDHIMA**



